# FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE

## *(FKSHC - KCSF)*

## *Prishtinë - Kosovë*

PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN QË
PERFUNDON ME 31 DHJETOR 2014

(bashkë me raportin e auditorit të pavarur)
Prishtinë, 24 mars 2014

**Përmbajtja**


| | Page |
|---|---|
| Raporti i Auditorit të Pavarur | |
| Identifikimi | 1 |
| Pasqyra e gjendjes financiare | 2 |
| Pasqyra permbledhese e të ardhurave | 3 |
| Pasqyra e ndryshimeve në bilacën e fondeve | 4 |
| Shënimet e pasqyrave financiare | 5-22 |
| Forma e Departamentit për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ | 23-24 |


***Shkurtesat***

| | |
|---|---|
| KCSF | Kosovar Civil Society Foundation |
| UNMIK | The United Nations Mission in Kosovo |
| NGO | Non Governmental Organization |
| | |
| ADA | Austrian Agency for Cooperation |
| BC | British Council |
| BCSDN | The Balkan Civil Society Development Network |
| BTD | Balkan Trust for Democracy |
| CSFG | Civil Society Grant Fund |
| EC | The European Commission in Brussels |
| EUOK | The European Union Office in Kosovo |
| EUROPEUM | EUROPEUM Institute for European Policy |
| FOSI | Foundation Open Society Institute |
| KFOS | Kosovo Foundation for Open Society |
| NOR | Royal Norwegian Embassy in Kosovo |
| SCO-K | Swiss Cooperation Office in Kosovo |
| SIPU | SIPU International AB |

**RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR**

**Për Drejtorin Ekzekutiv të**
**Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)**
**Prishtinë - Kosovë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (në tekstin e mëtejmë: "KCSF") Prishtinë - Kosovë cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014, dhe deklaratën e të ardhurave gjithëpëfshirëse, për vitin e mbyllur me këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera sqaruese.

*Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

*Përgjegjësia e Audituesve*
Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, ne kemi marrë në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat e njësisë ekonomike, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e brendshëm të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

*Opinion*
Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Fondacionit dhe të performancës së saj financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

**NSh "Balluku&Zhaveli" Ortakëri e pëgjithshme**
**Prishtina, Kosova**

Licensed Auditors Balluku & Zhaveli Prishtinë - Kosova

**Tomorr Zhaveli**
**Auditor Ligjor**

Prishtina, 24 mars, 2015

## 1. Identifikimi

### 1.1 Caktimi i Auditimit

**Klienti:** **Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (FKSHC)**
Venera Hajrullahu, Drejtore Ekzekutive
Fazli Grajqevci, 4/a
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381/ 38/ 248 636 248 643
Fax: +381/ 38/248 636 248 643
E-mail: www.kcsfoundation.org

**Kontraktuesi:** Balluku&Zhaveli, Ortakëri e përgjithshme
Tomorr Zhaveli, Ortak
Agim Ramadani 36/13
10000 Prishtinë. Kosovë
Tel: + 044 500 421
E-mail: tzhaveli@Yahoo.com

**Detyra:** **Auditimi i pasqyrave financiare të FKSHC me datë 31 dhjetor 2014**

### 1.3. Ekipi (Auditori) i Auditimit i ngarkuar

Tomorr Zhaveli, Auditor Ligjor

### 1.14. Personat kontaktues

Te FKSHC: Venera Hajrullahu, Drejtoreshë Ekzekutive
Vjollca Sllamniku, Udhëheqëse Financiare

# Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ("FKSHC")

## Pasqyra e gjendjes financiare

*Me 31 dhjetor 2014*

*(vlerat në Euro)*

| | Shënime | 31 dhjetor, 2014 | 31 dhjetor, 2013 |
|---|---|---|---|
| **Asetet Rrjedhëse** | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 5 | 738,646.29 | 325,596.94 |
| Kërkesat për reimbursim të TVSH | 6 | 1,236.95 | 176.07 |
| Kërkesat tjera | 7 | 5,121.89 | - |
| **Gjithsejtë I Asetet Rrjedhëse** | | **745,005.13** | **325,773.01** |
| **Aktivet e qëndrueshme** | | | |
| Aktiva e prekshme | 8 | 37,530.74 | 57,546.60 |
| **Gjithsejtë Aktivet e qëndrueshme** | | **37,530.74** | **57,546.60** |
| **Gjithsejtë Assetet** | | **782,535.87** | **383,319.61** |
| **Detyrimet dhe balanca e fondit** | | | |
| Detyrimet | 9 | 6,516.15 | 1,424.78 |
| Të pagueshmet – ndaj donatorit | 10 | 10,062.26 | 2,685.73 |
| Të hyrat e shtyera tjera- parapagimet | 11 | - | 2,500.00 |
| Të hyrat e shtyera | 16 | 728,426.72 | 319,162.50 |
| Fondet e përhershme të kufizuara – Aktivet e qëndrueshme | 8 | 37,530.74 | 57,546.60 |
| **Gjithsejtë Detyrimet dhe balanca e fondit** | | **782,535.87** | **383,319.61** |

Autorizuar nga menaxhmenti më 24. 03. 2015

Znj. Venera Hajrullahu
Drejtore Ekzekutive

Znj. Vjollca Sllamniku
Udhëheqëse Financiare

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave

## Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ("FKSHC")

### Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave

*Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014*

*(vlerat në Euro)*

| | Shënime | 31 dhjetor, 2014 | 31 dhjetor, 2013 |
|---|---|---|---|
| **Të hyrat** | | | |
| Grantet për projekte | 12 | 703,773.07 | 540,296.12 |
| Fonde tjera | 13 | 52,952.23 | 49,635.00 |
| Shitja e aktiveve të qëndrueshme | 14 | - | 1,000.00 |
| | | **756,725.30** | **590,931.12** |
| **Shpenzimet** | | | |
| Shpenzimet e projekteve | 15 | 514,565.23 | 256,092.12 |
| Shpenzimet e projekteve - Grantet | 15 | 82,127.91 | 233,974.61 |
| Shpenzimet Administrative | 15 | 131,308.32 | 98,435.65 |
| | | **728,001.46** | **588,502.38** |
| Shpenzimet tjera | 15 | 28,723.84 | 2,428.74 |
| **Ghithsejtë shpenzimet** | | **756,725.30** | **590,931.12** |
| **Teprica e fondeve mbi shpenzimet** | | **0.00** | **0.00** |

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave

# Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ("FKSHC")

## Pasqyra e ndryshimeve në balancën e fondeve

*Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014*

*(vlerat në Euro)*

| | Shënime | 31 dhjetor, 2014 | 31 dhjetor, 2013 |
|---|---|---|---|
| **Fondet e pranuara:** | | | |
| Kontributet | 12,13,14 | 756,725.30 | 590,931.12 |
| | | **756,725.30** | **590,931.12** |
| **Shpenzimet:** | | | |
| Shpenzimet e projekteve | 15 | 514,565.23 | 256,092.12 |
| Shpenzimet e projekteve - Grantet | 15 | 82,127.91 | 233,974.61 |
| Shpenzimet Administrative | 15 | 131,308.32 | 98,435.65 |
| Shpenzimet tjera | 15 | 28,723.84 | 2,428.74 |
| | | **756,725.30** | **590,931.12** |
| **Teprica / (deficiti) i periudhës** | | **0.00** | **0.00** |
| **Ndryshimet në Balancën e fondit** | | | |
| Balanca e fondit në fillim të vitit | | 57,546.60 | 70,753.98 |
| Balanca e fondit në fund të vitit | 8 | 37,530.74 | 57,546.60 |
| **Teprica e fondeve mbi shpenzimet për vitin** | | **(20,015.86)** | **(13,207.38)** |

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave